



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES**  
**SË KONSUMATORIT**  
**DPSUMK**

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit" Nr.2, Tiranë

Tel/Fax +355 04 225 539

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_ 2006

**URDHËR**

**Nr. 310 datë. 26.06.2006**

**MBI VENDOSJEN E NIVELEVE DHE FREKUENCAVE TË KAMPIONIMIT**  
**PËR MONITORIMIN E DISA SUBSTANCAVE DHE MBETJEVE NË KAFSHËT**  
**E GJALLA**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të Ligjit Nr.9308 dt. 04.11.2004 "Për Shërbimin dhe Inspektoriatin Veterinar", të Vendimit të Komisionit, 97/747/EC, me propozim të Drejtorisë së Përgjithshme të Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

**URDHËROJ:**

1. Nivelet dhe frekuencat e kampionimit për monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve në qumësht, vezë, mish lepuri, mish kafshësh të egra, kafshesh te egra te rritura ne ferma dhe në mjaltë përcaktohen në aneksin e këtij Urdhëri.
  2. Nivelet dhe frekuencat e përmendura në pikën 1 duhet të jenë në përputhje dhe të gjejne zbatim në Planin Kombëtar të Monitorimit të Mbetjeve.
  3. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Sigurisë Ushqimore dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, Drejtoritë Rajonale të Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Instituti i Kërkimeve Veterinare për zbatimin e këtij Urdhëri.
- Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTRI**

**Jemin GJANA**

## ANEKSI

### KREU I QUMËSHTI

#### 1. Qumësht gjedhi

##### **A. Kërkesat e kampionimit**

- Cdo kampion zyrtar merret nga autoritetet kompetente zyrtare ne menyre qe te jete e njohur ferma prej se ciles e ka origjinen qumeshti.

- Kampionet merren nga:

(a) ne nivel ferme nga rezervuari i grumbullimit te qumeshtit

(b) ose ne nivelin e industrise se qumeshtit perpara se sasia e qumeshtit te shkarkohet nga cisterna

- Perjashtime nga parimet e mesiperme te gjurmueshmerise se fermes se origjines mund te pranohet per substancat ose mbetjeve te parashikuara ne aneksin I te Rregullores Nr. 1 date 17.03.2000 "Mbi masat per monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve ne kafshet e gjalladhe produktet shtazore" per grupin B 3 (a), (b) dhe (c).

- Kampionet merren vetem nga qumeshti i paperpunuar

Sasia e kampionit qe merret varet nga metoda analitike qe perdoret.

##### **B. Niveli dhe frekuenca e kampionimit**

Numri vjetor i kampioneve eshte 1 per 15000 ton te prodhimit vjetor te qumeshtit, me nje minimum prej 300 kampionesh.

Egzaminimi i kampioneve duhet te behet si me poshte:

(a) 70% e kampioneve egzaminohen per pranine e mbetjeve te medikamenteve veterinare. Ne kete rast, secili kampion testohet per te pakten kater perberes te ndryshem, nga te pakten tre grupe, ndermjet grupeve A 6, B 1, B 2 (a) dhe B2 (e) te aneksit I te Rregullores Nr. 1 date 17.03.2000 "Mbi masat per monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve ne kafshet e gjalladhe produktet shtazore"

(b) 15% e kampioneve testohen per pranine e mbetjeve te pershkruara ne grupin B 3 te aneksit I te Rregullores Nr. 1 date 17.03.2000 "Mbi masat per monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve ne kafshet e gjalladhe produktet shtazore"

(c) Diferenca (15 %) vendoset ne varesi te situates perkatese.

#### 2. Qumësht nga specie të tjera (dele, dhi, kuaj)

Numri i kampioneve per keto specie percaktohet ne baze te niveleve te prodhimit dhe problemeve te identifikuara. Qumeshti nga keto specie perfshihet ne planin e kampionimit, si kampione shtese te atyre qe merren per qumeshtin e gjedhit.

**KREU II**  
**VEZËT**  
**1. Vezë pule**

**A. Kërkesat e kampionimit**

- Cdo kampion zyrtar merret nga autoritetet kompetente zyrtare ne menyre qe te jete e njohur ferma prej se ciles e kane origjinen vezet.
- Kampionet merren
  - (a) ne nivel ferme
  - (b) apo ne nivelin e qendrave te paketimit
- Masa e kampionit eshte te pakten 12 veze apo me shume, sipas metodave analitike te perdorura.

**B. Niveli dhe frekuenca e kampionimit**

Numri i kampioneve qe merren cdo vit eshte te pakten 1 per 1000 ton te prodhimit vjetor per konsum vezesh, me nje minimum prej 200 kampionesh.

Shperndarja e kampioneve percaktohet ne baze te struktures se prodhimit kombetar. Te pakten 30 % e kampioneve grumbullohet nga qendrat e paketimit, qe perfaqesojne pjesen me te rendesishme te vezeve per konsum human.

**Egzaminimi i kampioneve bëhet si më poshtë:**

- (a) 70 % e kampioneve testohen per te pakten nje perberes nga secili grup i meposhtem: grupet A 6, B 1, B 2 (b) te permendur ne aneksin II te Rregullores Nr. 1 date 17.03.2000 “Mbi masat per monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve ne kafshet e gjalladhe produktet shtazore”.
- (b) 30 % e kampioneve vendosen sipas sipas situates, por duhet te perfshijne disa analiza per substancat ne grupin B 3 (a) te aneksit I.

**2. Vezë nga specie të tjera të shpendëve**

Numri i kampioneve per keto specie percaktohet nga MBUMK sipas niveleve te prodhimit dhe problemeve te identifikuara. Vezet e ketyre specieve perfshihen ne planin e kampionimit si kampione shtese te atyre qe merren per vezet e pulave.

**KREU III**  
**MISHI LEPURIT DHE MISHI TË KAFSHËVE TË EGRA DHE ATYRE TË**  
**EGRA QË MBARËSHTROHEN**  
**1. Mishi i lepurit**

**A. Kërkesat e kampionimit**

- Nje kampionim konsiston ne nje apo me shume kafshe nga i njejti prodhues, ne perputhje me kerkesat e metodave analitike.
- Cdo kampion zyrtar duhet te merret nga inspektori zyrtar ne nje menyre te tille qe gjithmone te jete e mundur te gjurmohet deri tek ferma e origjines se lepujve.
  - Kampionet ne perputhje me strukturen e prodhimit te lepujve, mund te merren:

(a) ne nivelin e fermes

(b) apo ne nivelin e thertoreve te regjistruara

Pa shkelur kushtet e Rregullores Nr. 1 date 17.03.2000 "Mbi masat per monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve ne kafshet e gjalladhe produktet shtazore" disa kampione shtese te ujit te pijshem dhe ushqimit per kafshe, mund te merren ne nivelin e fermes, per kontrollin e substancave ilegale.

### **B. Niveli dhe frekuencat e kampionimit**

Numri i kampioneve qe duhen marre cdo vit, duhet te jete i barabarte me 30 per 300 ton te prodhimit vjetor (peshe e therur) per 3000 tonet e pare te prodhimit dhe 1 kampion per cdo 300 ton shtese.

Egzaminimi i kampioneve behet si me poshte: (duke iu referuar Rregullores Nr. 1 date 17.03.2000 "Mbi masat per monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve ne kafshet e gjalladhe produktet shtazore")

- Grupi A: 30 % e numrit total te kampioneve

70 % duhet te kontrollohen per substancat e Grupit A 6

30 % duhet te kontrollohen per nengrupet e tjera te grupit A

- Grupi B: 70 % e numrit total te kampioneve

30 % duhet te kontrollohen per substancat e Grupit B 1

30 % duhet te kontrollohen per substancat e Grupit B 2

10 % duhet te kontrollohen per substancat e Grupit B 3

Diferenca duhet te vendoset ne varesi te situates perkatese.

## **2. Kafshët e gjuetisë që mbarështrohen**

### **A. Kërkesat e kampionimit**

Masa e kampionit do te varet nga metodat analitike te perdorura.

Kampionet duhet te merren ne nivelin e perpunimit. Duhet te jete e mundur te gjurmojne kafshet apo mishin e tyre deri ne fermen e origjines.

Pa shkelur kushtet e Rregullores Nr. 1 date 17.03.2000 "Mbi masat per monitorimin e disa substancave dhe mbetjeve ne kafshet e gjalladhe produktet shtazore" disa kampione shtese te ujit te pijshem dhe ushqimit per kafshe, mund te merren ne nivelin e fermes, per kontrollin e substancave ilegale.

### **B. Niveli dhe frekuencat e kampionimit**

Numri i kampioneve qe duhen marre cdo vit, duhet te jete te pakten i barabarte me me 100 kampione.

**Egzaminimi i kampioneve bëhet si më poshtë:**

- Grupi A: 20 % e numrit total te kampioneve

Pjesa me e madhe e kampioneve duhet te analizohen per perberes te grupit A 5 dhe A 6.

- Grupi B: 70 % e numrit total te kampioneve

30 % duhet te kontrollohen per substancat e Grupit B 1

30 % duhet te kontrollohen per substancat e Grupit B 2 (a) dhe (b)

10 % duhet te kontrollohen per substancat e Grupit B 2 (c) dhe (e)  
30 % duhet te kontrollohen per substancat e Grupit B 3

### **3. Kafshët e egra**

#### **B. Kërkesat e kampionimit**

Masa e kampionit do te varet nga metodat analitike te perdorura.

Kampionet duhet te merren ne nivelin e perpunimit apo ne vendin ku jane vrare.

Duhet te jete e mundur te gjurmohen kafshet deri ne rajonin ku jane vrare.

#### **B. Niveli dhe frekuencat e kampionimit**

Numri i kampioneve qe duhen marre cdo vit, duhet te jete te pakten i barabarte me me 100 kampione.

Keto kampione duhet te merren per tu analizuar mbetjet per elementet kimike.

## **KREU IV**

### **MJALTI**

#### **A. Kërkesat e kampionimit**

Masa e kampionit do te varet nga metodat analitike te perdorura.

Kampionet mund te merren ne cdo pike te zinxhirit prodhues, dhe te jete e mundur te gjurmoje mjaltin deri ne prodhuesin fillestar.

#### **B. Niveli dhe frekuencat e kampionimit**

Numri i kampioneve qe duhen marre cdo vit, duhet te jete te pakten i barabarte me 10 per 300 ton te prodhimit vjetor per 3000 tonet e pare te prodhimit dhe 1 kampion per cdo 300 ton shtese.

**Egzaminimi i kampioneve bëhet si më poshtë:**

**- Grupi B 1 dhe grupi B 2 (c): 50 % te numrit total te kampioneve**

**- B 3 (a), (b) dhe (c): 40 % te numrit total te kampioneve**

Diferenca (10 %) vendoset ne varesi te eksperiences. Ne vecanti duhet bere kujdes me mikotoksinat.

